



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. 1002 prot

Durrës, më 26.07 2021

VENDIM

Nr. 10, datë 26.07 2021.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 26.07.2021,

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Dekanëve të fakulteteve, për njohjen me shkresën nr. 4032 prot, datë 19.07.2021 të Ministrisë Arsimit Sportit dhe Rinisë, në marrjen e masave për aplikimet në ofrimin e programeve të studimit edhe në gjuhën angleze.
2. Ngarkimin e Drejtorisë Administrimit Financiare në bërjen e një analize më të hollshme, bazuar në VKM në lidhje me tarifat e studimit për studentet që ndjekin program të dytë studimi.
3. Ngarkimin e Dekanëve të fakulteteve, në marrjen e masave të vazhdueshme sipas pikes 5 të vendimit të Rektoratit nr. 9 date 30.06.2021 për të çuar përpara procesin e dilpomave të dyfishta/ përbashkëta me institucionet e arsimit të lartë në vëndet e BE-së.
4. Ngarkimin e Dekanëve të fakulteteve, në marrjen e masave për zbatimin me rigorozitet të Rregullores së Kontrollit të Dijeve, për studentet që japin provimet e ndërmjetme.
5. Ngarkimin e Dekanëve të fakulteteve, për përcaktimin e anëtarëve të grupeve të punës për renditjen e studentëve fitues që do të pranohen në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2021-2022. Grupi i punës duhet të jetë i organizuar nga 3-5 anëtarë për çdo Departament të Fakultetit (një grup pune për çdo departament).
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi
 - Zv.Rektorët
 - Administratori
 - Dekanët e Fakulteteve
 - Drejtoria e Administrimit Financiare.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

R E K T O R
Prof.Dr. Kseanela **SGJROFSKI**

